



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**“ISA BOLETINI”**

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

UNIVERSITETI I MITROVICËS  
UNIVERSITY OF MITROVICA  
ISA BOLETINI  
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

Pranuar më dat 11.03.2020			
Njesia org	Numer	Nr ekzempl	Vlera
	142		

# **RAPORT VJETOR**

## **2019**

**Mitrovicë**  
**Shkurt 2020**

## **HYRJE**

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike është njësi akademike e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", i cili ka si mision angazhimin në mësimdhënie dhe kërkime shkencore në lëmin e Makinerisë Prodhuese, Inxhinierisë Ekonomike dhe Informatikës Inxhinierike.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike ka për qëllim të krijojë ambient inovativ dhe stimulues në të cilin studentët mund të zhvillojnë idetë, punën praktike dhe hulumtuese në fushat përkatëse.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike gjatë vitit 2018 ka synuar realizimin e misionit të tij, në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi dhe me objektivat e parashikuara.

Si objektiva kryesore, në kuadër të procesit të mësimdhënjes, janë identifikuar;

- Pajisja e studentëve me njohuritë më bashkëkohore;
- Përfshirja aktive e studentëve në procesin e të mësuarit, nëpërmjet nxitjes së të menduarit kritik;
- Angazhimi i studentëve në problematikat aktuale;
- Afrimi i studentëve drejt kërkimit shkencor;

Politikat e kërkimit shkencor edhe gjatë vitit 2019, kanë synuar të arrijnë këto objektiva:

- Të rrisin performancën shkencore të personelit akademik me dimensionet bashkëkohore dhe nivelin kërkimor europian;
- Të gjenerojnë kërkim shkencor, nëpërmjet: organizimit apo pjesmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të personelit akademik; bashkëpunimit me profesorë vëndas dhe të huaj; bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë për trajnimin dhe kualifikimin e stafit akademik;
- Të kthejnë fakultetin në një qendër të vlerave elitare dhe konkurruese;

Gjatë vitit 2019, është punuar me seriozitet për realizimin e objektivave, rekomandimeve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, si edhe për garantimin e standardeve të cilësisë nëpërmjet:

- Programeve dhe metodave të mësimdhënies bashkëkohore;
- Stafit akademik cilësor, me tituj dhe grada shkencore si dhe me eksperiencë punë;

- Ofrimit të shkollimit për një numër të arsyeshëm studentësh, konform kapaciteteve që fakulteti disponon;
- Sigurimit të ambjenteve dhe logjistikës së përshtatëshme për realizimin e çdo aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor.

Gjatë vitit 2019, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike përmbushi synimet e planifikuara në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

### **PROCESI I AKREDITIMIT**

Programet e akredituara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim të cilat funksionojnë në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike janë;

Makineri Prodhuese BSc,

Informatikë Inxhinierike BSc,

Inxhinieri Ekonomike BSc,

Inxhinieri Ekonomike MSc, por që nuk ka filluar procesi mësimor për shkak të mos akreditimit institucional.

Gajtë kësaj periudhe, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike ka zhvilluar një bashkëpunim dhe komunikim korrekt me Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Në vazhdimësi janë duke u përmbushur rekomandimet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

### **PROCESI I MBARËVAJTJES SË MËSIMIT**

Procesi i mbarëvajtjes së mësimit është zhvilluar normalisht, me gjithë vështërsitë e ndryshme. Po ashtu pajisjet kompjuterike, për shkak të mungesës së zyrtarit për mirëmbajtjen (për të cilin kemi parashtruar disa kërkesa për hapjen e vendit të punës) janë përcjellë me probleme dhe një pjesë e tyre janë jasht funksionit. Me gjithë vështërsitë, Laboratori i FIMK-ut ka qenë në shërbim të nevojave të studentëve.

Sfidë e madhe mbetet mirëmbajtja e pajisjeve laboratorike dhe furnizimi me kohë me materiale për zhvillimin e punës praktike të studentëve.

Një tjetër sifidë në këtë sektor, është largimi nga Kosova dhe shkëputja e marrëdhënjes së punës nga laborantët e angazhuar në Laboratorin e Makinerisë. Edhe tani kur po hartohet ky raport, në

Laboratorin e Makinerisë nuk kemi asnjë laborant për zhvillimin e ushtrimeve dhe punës praktike me studentë.

### **PROCESI I REALIZIMIT TË PROVIMEVE NËPËR AFATE**

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, ka organizuar sipas dinamikës mbajtjen e provimeve, sipas kalendarit të miratuar dhe sipas afateve të përcaktuara me Statutin e UMIB-it dhe vendimet e Senatit të UMIB-it. Provimet janë realizuar në përgjithësi pa probleme.

Edhe gjatë këtij viti, FIMK-u është ballafaquar me kërkesa dhe sfidën e transferimit të studentëve nga programet e UP-së në programet e UMIB-it.

### **PROCESI I REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE**

Procesi i regjistrimit të studentëve në vitin akademik 2019/20, edhe pse janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, nuk është realizuar fare për shkak të mungesës së akreditimit institucional.

Vlenë të përmendet se çdo ditë e më shumë po rritet numri i kërkesave nga studentë për çregjistrim dhe lëshimin e vërtetimeve për punë jashtë Kosovës.

Numri i të diplomuarve në vitin 2019 sipas programeve dhe niveleve:

Të diplomuar	BSc.	MSc.	MP. BSc.	INF. BSc.	IE. BSc.	TP. MSc.	INF. MSc.
65	53	12	6	29	18	5	7

### **PROCESI I REKRUTIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK**

Procesi i rekrutimit të stafit akademik, është përcjellë me sfida dhe vështërsi të shumta. Këto sfida kryesisht kanë të bëjnë me mungesën e kuadrove, me thirrje akademike PhD, sidomos në fushën e makinerisë, informatikës, matematikës etj. Po ashtu nuk janë realizuar të gjitha kërkesat e fakultetit drejtuar rektoratit për hapjen e konkurseve për vende të lira të punës për personel akademik dhe personel administrativ. Për ta vështërsuar edhe më shumë këtë proces ka ndikuar hapja me vonesë e konkursit për staf akademik. Ky veprim ka shkaktuar vështërsi tejet të mëdha për fillimin me kohë dhe me rregull të vitit akademik, pastaj ka ndikuar direkt në mënyrë negative në përmbushjen e kriterëve për akreditimin dhe ri/akreditimin e programeve mësimore, duke pamundësuar deklarin me kohë të stafit akademik në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

### **KËSHILLI I FAKULTETIT**

Këshilli i Fakultetit, ka zhvilluar punën bazuar në Statutin e UMIB-it dhe Rregulloren mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit.

Gjatë vitit 2019, Këshilli i Fakultetit, ka mbajtur trembëdhjetë mbledhje, në të cilat janë marrë vendime nga fusha përkatëse, janë aprovuar kërkesa, propozime etj. Këshilli i Fakultetit ka zhvilluar punën normalisht.

Edhe gjatë vitit 2019, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike ka ruajtur kontakte dhe korrespondencën korrekte me MASHT, AKA, në respekt të detyrimeve që burojnë nga ligji për Arsimin e Lartë.

### **ZGJEDHJET 2019**

Gjatë vitit 2019, janë organizuar dhe mbajtur zgjedhjet studentore dhe zgjedhjet e përgjithëshme në Universitetin e Mitrovicës, përkatësisht edhe në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.

Fillimisht janë organizuar zgjedhjet studentore, me ç'rast janë zgjedhur organet drejtuese të Këshillit të Studentëve.

Zgjedhjet e përgjithëshme janë mbajtur në frymë të mirë organizimi, pa ndonjë vërejtje. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike ka zgjedhur të gjitha organet drejtuese të cilat janë funksionale.

### **PJESËMARRJA DHE PROJEKTET E REALIZUARA**

Me datën 14 dhe 15 shkurt 2019, dy profesorët e FIMK-ut Faton Merovci dhe Muzafer Shala kanë marrë pjesë në takimin e parë të projektit Innovative Teaching Education in Mathematics – iTEM ku UMIB është pjesë e këtij projekti. Takimi është mbajtur në Technological Educational Institute of Crete, Chania, Crete, Greqi.

Në kuadër të vazhdimit të realizimit të projektit iTEM, me datën 18 dhe 19 Qershor është mbajtur takimi i parë i progresit për projektin iTEM. Në këtë takim nga FIMK kanë marr pjesë tre profesorë: Faton Merovci, Muzafer Shala dhe Arbëri Krasniqi.

Nga data 27 deri me 31 tetor 2019, në kuadër të projektit “Innovative Teaching Education in Mathematics”(iTEM) dy profesorë të FIMK-ut kanë realizuar vizitën e radhës në Universitetin e Aalborgut në Kopenhagë, Danimarkë.

Në këtë punëtori kanë qenë 43 pjesëmarrës nga shtete të ndryshme, si Kosova, Danimarka, Suedia, Austria, Maqedonia e Veriut, Greqia dhe Uzbekistani. Universiteti i Mitrovicës në këtë punëtori është përfaqësuar nga profesorë të Matematikës Faton Merovci dhe Arbëri Krasniqi.

Si pjesë e avancimit të njohurive praktike, në kuadër të lëndëve Rrjetat Kompjuterike dhe Komunikimet me Fije Optike, më 15.11.2019, studentët e vitit të tretë të udhëhequr nga Profesori Berat Ujkani realizuan vizitë në Telekomin e Kosovës në Mitrovicë. Qëllimi i vizitës ishte njoftimi për së afërmi me teknologjitë dhe procesin teknik të punës që ndodh në Telekomin e Kosovës.

Me qëllim të avancimit të njohurive në fushën e programimit në Departamentin e Informatikës Inxhinierike në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike është themeluar "Klubi i programimit dhe dizajnit grafik. Ky klub drejtohet nga shefi i Departamentit të Informatikës Inxhinierike, Ass. Berat Ujkani.

Ndryshe klubi synon të mbledh të gjithë studentët që kanë interes të shtuar për programim, të cilët përmes takimeve të rregullta në kampus punojnë praktikisht të avancojnë dijet e tyre. Shefi i departamentit, tregon se ky aktivitet do të mbahet tri herë në javë.

## **REKOMANDIME**

Bazuar në rezultatet e arritura dhe sfitat që kishim gjatë vitit 2018, ne si njësi akademike përmes rekomandimeve propozojmë implementimin e politikave, programeve dhe projekteve të ndryshme, në interes të ngritjes së preformancës dhe cilësisë së punës dhe shërbimeve.

- Procedimi me kohë i kërkesave për zgjedhjen e stafit akademik,
- Komunikim i vazhdueshëm sidomos me stafin akademik në marrëdhënje të rregullt pune, duke ju ofruar kushte të volitshme pune në mënyrë që të ketë stabilitet dhe mos largim të tyre nga marrëdhënja e punës me institucionin tonë,
- Nevoja e madhe e punësimit të një zyrtari të teknologjisë informative (për të cilin vazhdimisht kemi bërë kërkesa),
- Ngritja e kapaciteteve profesionale në Laboratorët e fakultetit,
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit administrativ,
- Ngritje në nivel më të lartë e komunikimit institucional,



Dekani

Prof. Dr. Hakif Zeqiri